



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 176 Prot.

Tiranë, më 09.01. 2018

UDHËZIM

NR. 1, DATË 09.01.2018

PËR

ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË,
VITI SHKOLLOR 2018-2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26 dhe 50 të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, dt.10.12.2010 “Për krijimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, të ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10.02.2013 “Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë, për vitin shkollor 2018-2019, do të zhvillohen si më poshtë:
 - a. Lënda gjuhë e huaj, më 10 qershor 2019.
 - b. Lënda gjuhë shqipe, më 18 qershor 2019.
 - c. Lënda matematikë, më 21 qershor 2019
2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën gjuhë amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën gjuhë amtare, do të zhvillohet më 14 qershor 2019.
3. Lista e gjuhëve të huaja, që do të jepen si provim i detyruar janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Testi i gjuhës/ve të huaj/a hartohet në përputhje me gjuhën, e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.
4. Nxënësit e klasave të 9-ta të seksioneve dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

5. Provimet kombëtare të arsimit bazë, fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.
6. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren për "Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018- 2019".
7. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastrë. Në ditën e provimit, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar Delvinë dhe Sarandë, tërheqin tezën në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Gjirokastrë.
8. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, përgatitet nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar Korçë.
9. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
10. Për institutin e nxënësve që nuk shikojnë "Ramazan Kabashi", drejtorja e këtij instituti tërheq testin nga QShA-ja, një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.
11. Nxënësi mbetës në provimet kombëtare të arsimit bazë, ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.
12. Institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.
13. Arkivimi i testeve të bëhet pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.
14. Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, merr nga Qendrat e Vlerësimit të Testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen në QShA, institucionin përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar dhe MASR.
15. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin

parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin
parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR



Lindita Nikolla

